

## STATUT

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR SERDI SHPK

Në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, dhe të Aktit të Themelimit të Shoqërisë SERDI SHPK ("Shoqëria"), veprimtaria e saj do të organizohet dhe drejtohet sipas dispozitave të këtij Statuti:

#### Neni 1

##### Emërtimi

- 1.1 Emërtimi i Shoqërisë është **SERDI SHPK** ndjekur pandashmërisht nga prapashtesa SHPK, e cila përfaqëson formën ligjore të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.
- 1.2 **SERDI** do të ketë shenjat e veta dalluese dhe vulën e saj, e cila miratohet nga Ortaku i vetëm i Shoqërisë.

#### Neni 2

##### Forma ligjore

- 2.1 Shoqëria është një person juridik shqiptar, e cila ka formën juridike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, dhe e zhvillon veprimtarinë e vet në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Civil, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, dhe Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar.

#### Neni 3

##### Objekti

- 3.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë:
- Tregtimi i produkteve ushqimore, blegtorale si dhe artikujve të tjerë industrial.
- 3.2 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet në përputhje me dispozitat ligjore, të zbatueshme me vendim të ortakut të vetëm / Asamblesë së Ortakëve.

#### Neni 4

##### Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.
- 4.2 Vendosja e mëpasshme e një kufizimi në kohë është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

#### Neni 5

##### Selia

- 5.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në Krujë, në adresën: Durrës, Krujë, Fushë Krujë, Fshati Larushk, Zona Kadastrale Nr. 2385 Nr. Pasurie 1 Ndërtesë private 1 katëshe
- 5.2 Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë këtij territori, duke hapur zyra apo degë ose nëpërmjet veprimtarive të kryera në përputhje me misionin dhe statutin e Shoqërisë, si dhe legjislacionin në fuqi.

**Neni 6**  
**Kapitali themeltar**

- 6.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është në vlerën 100.000 Lekë e përbërë një kuotë e vetme.
- 6.2 Ortaku i vetëm i shoqërisë është:  
Z. **Abdulla Doku**, shtetas shqiptar, lindur më 01-06-1968, i cili zoteron 100% të kuotës të kapitalit themeltar të shoqërisë me vlerë të përgjithshme 100.000 Lekë (njëqind mijë).

**Neni 7**  
**Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit**

- 7.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me Vendim Ortakut të vetëm të Shoqërisë / Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme me Ortakëve

**Neni 8**  
**Transferimi i pjesëve të kapitalit**

- 8.1 Kuota e kapitalit të Shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej saj mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
  - shitblerjes;
  - trashëgimisë;
  - dhurimit;
  - çdo mënyrë tjeter të parashikuar më ligj.
- 8.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek të tretët.
- 8.3 Miratimi për transferimin e kuotës bëhet nga me Vendim Ortakut të vetëm të Shoqërisë / Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve

**Neni 9**  
**Organi vendimmarrës**

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme me Ortak të vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë (në vazhdim Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve).
- 9.2 Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të Statutit në përputhje me dispozitat ligjore.
- 9.3 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
  - ndryshimet e Statutit;
  - emërimin e shkarkimin e administratorit/ve;
  - emërimin dhe shkarkimin e likuiduesit/ve dhe te ekspertit/ëve kontabël;
  - përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjën "c" e "d" të pikës 9.3 të Statutit;
  - mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
  - pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - riorganizimin, falimentimin, likuidimin dhe prishjen e Shoqërisë;
  - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
  - çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti dhe të cilat nuk janë kompetencë e administratorit/ëve.

- 9.4 Çdo ndryshim Statuti duhet të depozitohet në QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.
- 9.5 Të drejtat e Asamblesë së Përgjithshme do të ushtrohen nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë, për sa kohë që kapitali themeltar do të zotërohet vetëm nga një ortak.

#### **Neni 10**

##### **Kuorumi**

- 10.1 Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ose të autorizuarit e tyre të posaçëm.

#### **Neni 11**

##### **Administrimi**

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme emëron 1 (një) Administrator të Shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.
- 11.2 Administratori i vetëm i Shoqërisë, do të jetë:  
**Z. Abdulla Doku**, shtetas shqiptar, lindur në Verjon, Krujë më 01-06-1968, dhe banues në Verjon, Krujë.
- 11.3 Administratori ka të gjitha kompetencat si një organ ekzekutiv i shoqërisë për të vepruar në marrëdhënie më të tretët në emër të Shoqërisë, në të gjitha rrëthanat e lejuara nga statuti dhe ligji i zbatueshëm.

#### **Neni 12**

##### **Përgjegjësitë e Administratorit**

- 12.1 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të Ligjit "Për Tregtarët e Shoqëritë Tregtare" Administratori detyrohet:
- të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në Statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë veprimtarisë së Shoqërisë në mjeshter tregtar dhe përkatës;
  - të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në Statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - të parandalojë dhe mënjanjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të Shoqërisë;
  - të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm, siç kërkonet në dispozitat ligjore të zbatueshme.
  - të sigurojë zbatimin e legjisacionit në fuqi për shoqëritë.

#### **Neni 13**

##### **Viti Financiar**

- 13.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon në 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Përashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor të vitit përkatës.

#### **Neni 14**

##### **Kontrolli Financiar**

- 14.1 Shoqëria mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël të autorizuar për kryerjen e kontrollit financiar të veprimtarisë së saj.

**Neni 15**  
**Prishja e Shoqërisë**

- 15.1 Prishja e Shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:
- me vendim të Ortakut të vetëm të Asamblesë së Përgjithshme;
  - me mbylljen e procedurave të falimentimit apo likuidimit vullnetar;
  - nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar (apo legjislacioni i zbatueshëm).
  - me vendim të gjykatës.
- 15.2 Ortaku i Vetëm / Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilën parashikojnë mënyrën e prishjes së Shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidues dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".
- 15.3 Prishja e Shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e paaftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i Vetëm / Asambleja e Përgjithshme të Ortakëve.
- 15.4 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas Vendimit të Ortakut të Vetëm / Asamblesë së Përgjithshme për prishjen e Shoqërisë, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 16**  
**Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi ndarja**

- 16.1 Shoqëria mund të ndahet dhe bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe në këtë Statut.

**Neni 17**  
**Dividenti**

- 17.1 Shoqëria do t'i shpërndajë Ortakut të vetëm të saj dividentin vjetor që mund të mbeten pasi të ketë përbushur të gjitha kërkeshat kontraktore dhe detyrimet ligjore, dhe detyrimet për mbajtjen e rezervave të domosdoshme dhe në përputhje me ligjin e zbatueshëm dhe pasi të jetë ndarë fondi për investim kapital nëse Ortaku i Vetëm / Asambleja e Përgjithshme do të vendsë për një të tillë.


**Neni 18**  
**Mosmarrëveshjet**

- 18.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti dhe funksionimin e Shoqërisë, palët i drejtohen legjislacionit shqiptar dhe synojnë zgjidhjen me mirëkuptim. Në rast të kundërt për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Statut hartohet në 2 (dy) ekzemplarë origjinalë në gjuhën shqipe.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË**

Abdulla DOKU



Faqe 4 nga 4